



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 35

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 13 mars 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Kuvendit nr. 30/2018, datë 5.3.2018	Për ngritjen e Komisionit Hetimor për të kontrolluar veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore në parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit dhe trafikut të lëndëve narkotike, përfshirë çështjen për të cilën prokuroria po heton z. Saimir Tahiri, ish-ministër i Brendshëm.....	2259
Vendim i Kuvendit nr. 31/2018, datë 5.3.2018	Për mosmiratimin e kandidaturës së znj. Brunilda Ali në detyrën e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.....	2259
Vendim i Kuvendit nr. 32/2018, datë 5.3.2018	Për mosmiratimin e kandidaturës së znj. Elona Turku në detyrën e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.....	2260
Vendim i Kuvendit nr. 33/2018, datë 5.3.2018	Për mosmiratimin e kandidaturës së z. Odise Moçka në detyrën e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.....	2260
Vendim i Kuvendit nr. 34/2018, datë 5.3.2018	Për mosmiratimin e kandidaturës së z. Leonard Gremshi në detyrën e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.....	2260
Vendim i Kuvendit nr. 35/2018, datë 5.3.2018	Për mosmiratimin e kandidaturës së znj. Oriela Shishi në detyrën e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.....	2260
Vendim i Kuvendit nr. 36/2018, datë 5.3.2018	Për mosmiratimin e kandidaturës së znj. Marsuela Aliaj në detyrën e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.....	2261
Vendim i Kuvendit nr. 37/2018, datë 5.3.2018	Për mosmiratimin e kandidaturës së znj. Arlinda Pogaj në detyrën e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.....	2261
Vendim i Kuvendit nr. 38/2018, datë 5.3.2018	Për mosmiratimin e kandidaturës së znj. Valbona Kadëna në detyrën e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.....	2261

Vendim i Kuvendit nr. 39/2018, datë 5.3.2018	Për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.....	2261
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.2.2018	Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, në zonën me rëndësi për fondin e mbështetjes së investimeve strategjike.....	2262



**VENDIM
Nr. 30/2018**

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT
HETIMOR PËR TË KONTROLLUAR
VEPRIMET DHE MOSVEPRIMET E
ORGANEVE SHTETËRORE NË
PARANDALIMIN DHE GODITJEN E
FENOMENIT TË KULTIVIMIT DHE
TRAFIKUT TË LËNDËVE NARKOTIKE,
PËRFSHIRË ÇËSHTJEN PËR TË CILËN
PROKURORIA PO HETON Z. SAIMIR
TAHIRI, ISH-MINISTËR I BRENDSSHËM**

Bazuar në nenet 77 e 78 të Kushtetutës dhe në mbështetje të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit”, me propozimin e një grupi prej më shumë se ¼ të anëtarëve të pakicës parlamentare,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor për të kontrolluar veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore në parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit dhe trafikut të lëndëve narkotike, përfshirë çështjen për të cilën Prokuroria po heton z. Saimir Tahiri, ish-ministër i Brendshëm.

II. Verifikohet çdo lloj dyshimi për ndikim të paligjshëm në ushtrimin e ndjekjes penale në mënyrë të pavarur nga organet kompetente të ngarkuara me ligj, në hetimin penal të këtij rasti.

III. Hetimi synon mbrojtjen e parimit të ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, shtetin e së drejtës dhe demokracinë funksionale, me qëllim parandalimin e pasojave negative për shtetin, qytetarët dhe interesin publik, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete institucionale.

IV. Komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, ndryshime apo miratime ligjesh dhe, sipas rastit, njoftimin e organeve përgjegjëse për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

V. Komisioni hetimor parlamentar përbëhet nga 11 deputetë. Përbërja e komisionit miratohet me vendim të Kuvendit.

VI. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 6-mujor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

VII. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që menjëherë të caktojë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, si dhe personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion edhe ekspertë juristë.

VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhrave të kryetarit të Kuvendit, për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 5.3.2018

**VENDIM
Nr. 31/2018**

**PËR MOSMIRATIMIN E
KANDIDATURËS SË ZNJ. BRUNILDA
ALI NË DETYRËN E ANËTARIT TË
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 19/2, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111, pika 8, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Të mos miratojë kandidaturën e znj. Brunilda Ali në detyrën e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 5.3.2018

**VENDIM**
Nr. 32/2018**PËR MOSMIRATIMIN E**
KANDIDATURËS SË ZNJ. ELONA
TURKU NË DETYRËN E ANËTARIT TË
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 19/2, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111, pika 8, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të mos miratojë kandidaturën e znj. Elona Turku në detyrën e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 5.3.2018

VENDIM
Nr. 33/2018**PËR MOSMIRATIMIN E**
KANDIDATURËS SË Z. ODISE MOÇKA
NË DETYRËN E ANËTARIT TË
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 19/2, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111, pika 8, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të mos miratojë kandidaturën e z. Odise Moçka në detyrën e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 5.3.2018

VENDIM
Nr. 34/2018**PËR MOSMIRATIMIN E**
KANDIDATURËS SË Z. LEONARD
GREMSHI NË DETYRËN E ANËTARIT
TË KOMISIONIT TË PROKURIMIT
PUBLIK

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 19/2, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111, pika 8, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të mos miratojë kandidaturën e z. Leonard Gremshi në detyrën e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 5.3.2018

VENDIM
Nr. 35/2018**PËR MOSMIRATIMIN E**
KANDIDATURËS SË ZNJ. ORIELA
SHISHI NË DETYRËN E ANËTARIT TË
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 19/2, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111, pika 8, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të mos miratojë kandidaturën e znj. Oriela Shishi në detyrën e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 5.3.2018



VENDIM
Nr. 36/2018

PËR MOSMIRATIMIN E
KANDIDATURËS SË ZNJ. MARSUELA
ALIAJ NË DETYRËN E ANËTARIT TË
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 19/2, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111, pika 8, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të mos miratojë kandidaturën e znj. Marsuela Aliaj në detyrën e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 5.3.2018

VENDIM
Nr. 37/2018

PËR MOSMIRATIMIN E
KANDIDATURËS SË ZNJ. ARLINDA
POGAJ NË DETYRËN E ANËTARIT TË
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 19/2, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111, pika 8, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të mos miratojë kandidaturën e znj. Arlinda Pogaj në detyrën e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 5.3.2018

VENDIM
Nr. 38/2018

PËR MOSMIRATIMIN E
KANDIDATURËS SË ZNJ. VALBONA
KADËNA NË DETYRËN E ANËTARIT TË
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 19/2, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111, pika 8, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të mos miratojë kandidaturën e znj. Valbona Kadëna në detyrën e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 5.3.2018

VENDIM
Nr. 39/2018

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
BORDIT TË INSTITUTIT TË
STUDIMEVE PËR KRIMET DHE
PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 8, dhe 18, të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Institutit të Integritetit të ish-të Përndjekurve Politikë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Uran Butka zgjidhet anëtar i Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 5.3.2018

**VENDIM****Nr. 138, datë 23.2.2018****PËR PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË
PROCEDURAVE TË KALIMIT NË
PRONËSI TË PËRFITUESVE TË TOKËS
BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE
BUJQËSORE DHE TË REGJISTRIMIT TË
AKTEVE TË MARRJES SË TOKËS NË
PRONËSI, NË ZONËN ME RËNDËSI
PËR FONDIN E MBËSHTETJES SË
INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar, të nenit 9, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, të neneve 25 e 45, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, dhe të neneve 27 e 31, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pezullimin e përkohshëm të vijimit të procedurave të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, në zonën me rëndësi për fondin e

mbështetjes së investimeve strategjike, sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi, publikuar edhe në Gjeoportalin Kombëtar, të administruar nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), deri në krijimin e Fondit të Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike, sipas nenit 31, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, territori administrativ i të cilave përfshihet në hartën e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të pezullojnë procedurat e kalimit në pronësi të tokës së ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës, në zonën me rëndësi për fondin e mbështetjes së investimeve strategjike, pavarësisht nga faza procedurale, menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe bashkitë: Shkodër, Lezhë, Kurbin, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Konispol, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë